



THIRRJE PËR PJESMARRJE

Nga 1 Gushti deri në 1 Dhjetor 2014, Qendra Mjedisore për Mbrojtje, Edukim dhe Rehabilitim (EPER Center) me mbështetjen e Ministrisë Kulturës, Prefekturës Tiranë dhe Biznesve të Riciklimit në Shqipëri, do të realizojë projektin "Arti nëpërmjet Riciklimit" në rajonin e Tiranës. Projekti "Arti nëpërmjet Riciklimit" ka për qëllim fuqizimin e kapaciteteve krijuese tek të rinjtë e qarkut të Tiranës për artin pamor nëpërmjet riciklimit. Projekti do të asistohet nga profesorë dhe ekspertë të njohur në fushën e artit dhe mjedisit.

Në kuadër të kësaj nisme ftohen të rinjtë të aplikojnë për:

- o përfshirjen në shkollën verore "Arti nëpërmjet Riciklimit"
- o skicimin e projekt ideve të veprave të artit pamor me materiale të riciklueshme
- o ndërtimin e veprës artistike për rajonin e Tiranës

Kërkesat për aplikuesit:

- o Të jenë të moshës 18-30 vjeç
- o Të kenë njohuri në fushat artit apo mjedisit
- o Të kenë aftësi të mira komunikimi dhe të jenë të aftë të punojnë në grup
- o Të kenë njohuri të mira kompiuterike
- o Të kenë njohuri të gjuhës Angleze.

Të rinjtë e intersuar duhet të paraqesin: CV, letër motivimi dhe një projekt ide për ndërtimin e veprës së artit me materiale të riciklueshme me anën e adresës emailit: info@epercenter.org

Vetëm kandidatet që do të jenë përzgjedhur do të kontaktohen për një intervistë. Numri i të rinjve pjesëmarrës është 24 persona.

Afati i fundit i aplikimit është data 27 Gusht 2014, ora 17⁰⁰.

Qendra Mjedisore për Mbrojtje, Edukim dhe Rehabilitim (EPER Center)

Adresa: Rr. Aleksandër Moisiu, Pall. 72/1, Ap. 3, Tiranë

web: www.epercenter.org; www.riciklimi.al

email: info@epercenter.org; Tel: +355 42230262